


PRESIONI PËR KORRUPSION DHE PËRFSHIRJA NË KORRUPSION

Përvoja e qytetarëve me korrupsionin lidhet me dy indikatorë kryesorë të korrupsionit administrativ: përfshirja, pra dhënia e ryshfetit, dhe presioni, që nënkupton kërkesën për ryshfet. Të dhënat tregojnë se **50.7%** e qytetarëve pranojnë se kanë dhënë ryshfet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë tek zyrtarët publikë.

Kjo shifër është rritur me rreth **10%** krahasuar me vitin **2023**, çka tregon një përkeqësim të dukshëm të situatës. Edhe treguesi i presionit ndjek të njëjtin prirje, ku **53.9%** e të pyeturve thonë se u është kërkuar ryshfet.

Presioni i korrupsionit dhe përfshirja në korrupsion

Presioni për korrupsion dhe përfshirja në korrupsion – % e qytetarëve mbi 18 vjeç që janë pyetur ose kanë dhënë ryshfet (para, shërbime, dhurata) gjatë vitit të fundit.



- ▶ Në vitin **2025**, **54%** e qytetarëve ishin të ekspozuar ndaj presionit për korrupsion, ndërsa **59.0%** ishin të përfshirë në praktika korruptive.
- ▶ Krahasuar me vitin **2023**, niveli i përfshirjes është rritur me rreth **19%**.
- ▶ Një element i rëndësishëm është ngushtimi i diferencës midis presionit dhe përfshirjes.
- ▶ Ndërsa gjatë viteve të mëparshme, për shembull në **2023**, presioni (**52.1%**) ishte dukshëm më i lartë se përfshirja (**40.0%**), në **2025** qytetarët po marrin pjesë më masivisht në praktikat korruptive edhe kur presioni nuk është më i lartë. Kjo tregon një normalizim gradual të ryshfetit si mjet për të përshpejtuar ose zgjidhur çështje administrative.


Projeksione të presionit dhe përfshirjes në korrupsion

Rezultatet e anketës		Numri i popullsisë (projeksime)
54.0%	Presioni	1,276,188
59.0%	Persona	1,395,555

- ▶ Duke u bazuar në vlerësimin më të fundit të popullsisë, në vitin **2025** pothuajse **1,276,188** qytetarë të rritur janë pyetur të paktën një herë për të dhënë ryshfet, ndërsa mbi **1,395,555** qytetarë kanë dhënë ryshfet të paktën një herë gjatë vitit të kaluar, duke treguar përhapjen e korrupsionit administrativ.

Presioni i korrupsionit dhe përfshirja në korrupsion

ACER, CMS 2025




SJELLJET NDAJ KORRUPSIONIT

PRANIMI I KORRUPSIONIT (%)

Indeksi pasqyron nëse qytetarë e konsiderojnë të pranueshme që anëtarët e parlamentit, qeverisë apo zyrtarët në ministri dhe bashki të marrin dhurata, para, nder ose dreka falas në këmbim të zgjidhjes së një çështjeje personale të qytetarit.


% e qytetarëve mbi 18 vjeç që pranojnë forma të ndryshme korrupsioni:



Rezultatet tregojnë se shumica e qytetarëve (69%) nuk e shohin të pranueshëm këtë lloj praktike, duke shënuar një rritje prej 4% krahasuar me vitin 2023. 31% e respondentëve e konsiderojnë të pranueshëm rryshfetin, një rënie e ndjeshme krahasuar me 35% në vitin 2023.

Projektimi tregon se për rreth 733,627 qytetarë të rritur, korrupsioni konsiderohet një mënyrë e pranueshme e veprimit, një ulje e ndjeshme krahasuar me anketat e mëparshme. Ky ndryshim tregon një rritje të ndërgjegjësimit publik për korrupsionin dhe një qëndrim më kritik ndaj praktikave të padrejta.


Pranimi i korrupsionit



ACER, CMS 2025

NDJESHMËRIA NDAJ KORRUPSIONIT

Indeksi i ndjeshmërisë vlerëson sa qytetarët janë të prirur të komprometojnë vlerat e tyre nën presion, veçanërisht në situata reale ku duhet të vendosin nëse do të përfshihen në praktika korruptive, duke qenë plotësisht të vetëdijshëm për pasojat e menjëhershme të zgjedhjes së tyre.




- ▶ Viti 2025 përfaqëson një vazhdimësi të trendit të vërejtur në vitin 2023, pa shënuar ndryshime të forta strukturore në qëndrimet ndaj korrupsionit. 56% e të anketuarve klasifikohen si të ndjeshëm ndaj korrupsionit.
- ▶ Në të njëjtën kohë, 18% e respondentëve mbeten të pandjeshëm ndaj korrupsionit, çka tregon se një segment i shoqërisë vazhdon të shfaqë tolerancë ose indiferencë ndaj këtyre praktikave.
- ▶ Megjithatë kjo përqindje nuk paraqet rritje, prania e saj sinjalizon një problem strukturor që vijon të jetë i qëndrueshëm në kohë.
- ▶ Sjelljet me karakter të miksuara përbëjnë 26% të të anketuarve, duke konfirmuar ekzistencën e një grupi të ndërmjetëm me qëndrime ambivalente, i cili lëviz mes refuzimit dhe justifikimit të korrupsionit në varësi të rrethanave.



PERCEPTIMET MBI KORRUPSIONIN

PERCEPTIMI I QYTETARËVE MBI KORRUPSIONIN SIPAS PROFESIONEVE




Qytetarëve lu kërkua të ndanin opinionet e tyre për të identifikuar se cilat nga grupet e listuara perceptohen si më të prekur nga korrupsioni. Të dhënat tregojnë se lidhja e perceptuar e korrupsionit me individë ose profesione të caktuara është ulur ndjeshëm krahasuar me vitet e mëparshme.

■ Pothuajse të gjithë janë të përfshirë / Shumica janë të përfshirë ■ Pak janë të përfshirë / Pothuajse askush nuk është i përfshirë.

Perceptimet e korrupsionit për zyrtarët

- Më të korruptuarit




► Në vitet e kaluara, qytetarët i identifikonin si më të korruptuar gjyqtarët, doganierët, prokurorët publikë, zyrtarët e gjykatave dhe liderët politikë. Këtë vit, dy nga këto kategori të fundit janë zëvendësuar nga zyrtarët e taksave dhe pedagogët e universiteteve.

► Ky ndryshim është i rëndësishëm dhe përbën një fenomen të veçantë, pasi pedagogët janë perceptuar si një nga grupet më pak të prekura nga korrupsioni në vitet paraardhëse.

Perceptimet e korrupsionit për zyrtarët

- Më pak të korruptuarit



► Grupet që qytetarët i perceptojnë si më pak të korruptuar mbeten gazetarët dhe këshilltarët bashkiak, të cilët qëndrojnë në të njëjtën kategori si vitet e kaluara.

► Këtë vit ky grup përfshin edhe dy kategori të reja që zëvendësojnë mësuesit dhe pedagogët, konkretisht bankierët dhe drejtesit e organizatave joqeveritare.




PERCEPTIMET MBI KORRUPSIONIN

PERCEPTIMET MBI MUNDËSINË PËR KORRUPSION

Perceptimet për mundësinë e presionit për korrupsion – % e qytetarëve mbi 18 vjeç që e konsiderojnë presionin për korrupsion shumë të mundshëm ose të mundshëm kundrejt jo të mundshëm ose aspak të mundshëm


Perceptimet mbi mundësinë për korrupsion (%)



- ▶ Një trend paralel është ulja e numrit të respondentëve që nuk konsiderojnë të përdorin rryshfet për shërbime të nevojshme, nga **33%** në **2023** në **19%** në **2025**, një tregues i rritjes së mundësisë për presion korrupsioni.
- ▶ Rritja e probabilitetit të përdorimit të rryshfetit dhe ulja e besimit se shërbimet mund të merren pa përfshirje korruptive tregojnë nevojën për një kuadër të forcuar institucional.

EFIKASITETI I POLITIKAVE PËR PËRGJIGJE NDAJ KORRUPSIONIT

Perceptimet mbi realizueshmërinë e politikave kundër korrupsionit (%)



■ Korrupsioni mund të reduktohet ndjeshëm ose të çrrënjohet ■ Korrupsioni nuk mund të reduktohet ndjeshëm ■ Nuk e di/ Pa përgjigje

Rezultatet tregojnë se qytetarët mbeten mjaft pesimistë për të ardhmen: **77%** besojnë se situata aktuale do të vazhdojë, ndërsa vetëm **22%** shpresojnë në një të ardhme me nivele të ulëta korrupsioni.

Ky trend përkon me vlerësimet e viteve të mëparshme dhe tregon një hendek mes sjelljes individuale të qytetarëve, e cila po përmirësohet, dhe veprimeve institucionale, të cilat ende nuk duket se adresojnë plotësisht prirshmëritë dhe interesat e qytetarëve

Kur qytetarët vlerësojnë procesin e vendimmarrjes në vendin e tyre, shumica duket se janë skeptikë ndaj përfundimit të interesit publik.

Vetëm **10%** e tyre besojnë se vendimet e qeverisë reflektojnë nevojat e qytetarëve, ndërsa pjesa më e madhe, rreth **44%**, mendon se vendimet favorizojnë partitë politike.

Kjo tregon një perceptim të qartë se vendimmarrja nuk fokusohet te interesi i përgjithshëm, por te interesat private të grupeve më të fuqishme në shoqëri.

Vendimet e qeverisë në shërbim të interesave personale

